



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO**  
**KOMUNA E DRAGASHIT**  
**DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Datë: 05.08.2024

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLICA KOSOVA**  
**Komuna e Dragashit**  
**Opština Dragaš**

02 Nr. Br. 600/01-16376/24  
01-02-20 24  
**Dragash - Dragaš**

**PROCESVERBAL**  
**Dëgjimi buxhetor me Gra dhe Vajza për**  
**Buxhetin e vitit 2025**  
**I mbajtur më 31.07.2024 (e mërkurë)**  
**VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash**

Dëgjimi buxhetor me Gra dhe Vajza për Buxhetin e Komunës së Dragashit për vitin 2025 është mbajtur sipas Kalendarit të dëgjimeve buxhetore, të publikuar në uebfaqen zyrtare dhe Facebook më datën 17.07.2024.

**Kalendari i publikuar në uebfaqen zyrtare:**

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/07/Kalendari-i-degjimeve-shqip.pdf>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/07/Kalendari-i-degjimeve-boshnjakisht.pdf>

**Kalendari i publikuar në Facebook-un zyrtar:**

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/1XDgwzYBgvSjk63B/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/YSyDiSieUgUYH7h3/>

**Njoftimi në uebfaqen zyrtare:**

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/07/Degjimi-me-Gra-Scan.pdf>

Dëgjimi buxhetor ka filluar në ora 11:15 dhe ka përfunduar në ora 11:46.

Në këtë Dëgjim buxhetor kanë qenë prezentë **39 pjesëmarrës, prej tyre 2 meshkuj dhe 37 femra.**

Hapjen e takimit e ka bërë kryetari i Komunës, **Bexhet Xheladini**, i cili i ka falënderuar për pjesëmarrjen të gjithë të pranishmit. Siç e dini, në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, Ligjit për Financimin e Pushtetit Lokal, si dhe bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutit të Komunës, komunat janë të obliguara që të mbajnë debate publike me qytetarë për përgatitjen e Buxhetit për vitin 2025. Siç jeni të informuar, unë si kryetar i Komunës e kam formuar Grupin Punues për përgatitjen e Buxhetit, i cili është urë lidhëse në mes të kryetarit dhe grupeve të ndryshme të interesit, në mënyrë që ne të japim sa më shumë informata për buxhetin, si dhe sa më shumë kërkesa të marrim nga grupet e interesit. Sot kemi të caktuar debatin publik me Gra dhe Vajza, dhe kemi dëshirë që ju të jeni shumë aktive gjatë këtij dëgjimi buxhetor, të marrim nga ju propozime të rëndësishme të cilat unë, së bashku me Kabinetin, kryesuesen e Kuvendit, Asamblenë Komunale, me KPF-në, këto kërkesa të juaja t'i inkorporojmë në Buxhetin final. Unë nuk dua të jua marr më shumë kohën tuaj të çmueshme. I kisha lut panelistët këtu, kryesuesen, kryetarin, zyrtaren për Barazi Gjinore, nëse ka nevojë me e marrë fjalën, fjala është e tyre.

**Arijeta Skeraj, kryesuese e Kuvendit:** Përshëndetje kryetar! Përshëndetje për të gjithë të pranishmet! Unë vetëm pres nga ju kërkesat që do të na i dërgoni neve. Ju faleminderit!

**Lindita Kozmaqi Piraj, zyrtare për Barazi Gjinore:** Përshëndetje për të gjithë! Faleminderit kryetar për fjalën! Kam kënaqësinë që sot keni gjet kohën edhe jeni këtu bashkë me ne. Ashtu si tha kryetari, procesi i buxhetit edhe në aspektin ligjor është i obliguar për t'u përgatitur me një gjithëpërfshirje. Duhet të marrin pjesë si burrat, gratë, pleqtë, personat me aftësi të kufizuara, të gjitha kategoritë, pa dallim gjinie. Duke e pas parasysh praktikën edhe të kaluarën, që nëpër debatet të cilat i cakton Komuna dhe ka pjesëmarrje të burrave, gratë dhe vajzat tona hezitojnë të jenë të pranishme. Apo, edhe kur janë të pranishme, hezitojnë ta marrin fjalën edhe t'i shprehin ankesat, apo kërkesat e tyre për një shërbim, e kështu me radhë. Kështu që, qëllimi ynë sot ka qenë ta caktojmë këtë takim vetëm me gra dhe me vajza, që të ndiheni sa më të lira dhe komod, t'i shprehni nevojat e juaja, ku falë angazhimit dhe vullnetit politik të kryetarit me stafin e tij, pastaj t'i inkorporojmë në buxhetin komunal dhe prej tyre të përfitojmë të gjitha, si gra, si komunitet dhe si shoqëri. Ju inkurajoj secilën nga ju që dëshironi ta merrni fjalën, të jeni të lira dhe koha është e juaja në dispozicion.

**Resul Fetahu, nënkryetar i Komunës:** Faleminderit, kryetar! Përshëndetje për të gjithë! Ju falënderoj për këtë pjesëmarrje masive në këtë dëgjim buxhetor me Gra dhe Vajza!



**Bexhet Xheladini:** Falemnderit! Para se t'juja jap fjalën juve, unë po e bëj një rikujtim të Buxhetit. Ne gjatë përgatitjes së KAB-it kemi mbajtur tri debate publike, dhe në bazë të KAB-it ne kemi marrë të dhëna se sa është lartësia e buxhetit të Komunës sonë. Mirëpo, ne këtë debat jemi duke e mbajtur në mes të miratimit të KAB-it nga Asambleja Komonale dhe pritjes së Qarkores së Dytë Buxhetore. Ka mundësi që kjo Qarkore të vijë me ndryshime, por nëse ajo vjen me ndryshime, ne përmes uebfaqes do t'ju informojmë për ndryshimet që mund t'i pësojë KAB-i. Buxheti total i Komunës së Dragashit për vitin 2025 është **12,872,214 euro**. Nga këto mjete, për Paga shkojnë **5,844,424 euro**; për Mallra dhe Shërbime **1,513,342 euro**; Shërbime Komonale dhe Shërbime Publike **525,000 euro**; Subvencione **400,000 euro**; dhe Investime Kapitale **4,736,193 euro**. Unë tash ua kaloj fjalën juve. Për një moment e kam TV T7 këtu, do ta jap një intervistë të shkurtë. Ia kaloj udhëheqjen e mbledhjes nënkryetarit të Komunës. Ju falemnderit!

**Resul Fetahu:** Atëherë, pas fjalës së kryetarit, presim propozimet nga ana juaj!

**Suada Bajrami, asambleiste e Kuvendit:** Përshëndetje për të gjithë! Ne jemi duke e parë çdo ditë që po hasim në raste të shumta dhe të llojeve të ndryshme të kancerit, te gratë. Unë kam një propozim në emër të Grupit të Grave Asambleiste të Komunës së Dragashit. Propozoj që secila grua që është e prekur nga çfarëdo lloj i kancerit, të subvencionohet me 500 euro. Ndoshta është një shumë solide, por një përkrahje prej Kuvendit të Komunës, për me vazhduar ato tutje për trajtim. Falemnderit!

**Anesa Mehmeti, asambleiste e Kuvendit:** Përshëndetje! Unë si asambleiste, pas që tani në spitalin tonë kemi gjinekologjen, kam edhe një kërkesë. Kërkoj që kryetari t'ua mundësojë të gjitha grave të Komunës sonë që të bëjnë analizën e Papa Testit pa pagesë. Shpresoj që kjo kërkesë e imja të miratohet. Ju falemnderit!

**Ela Qafleshi, infermiere:** Përshëndetje për të gjithë! Siç e dini, ne kemi një gjinekologe në QKMF, e cila ka shumë vlerë të madhe tek ne. Si rritje të cilësisë së shërbimeve, kisha pas dëshirë që me pas mundësi për Papa Test. Edhe në qoftë se nuk ka mundësi në Komunën e Dragashit, të paktën të marrim Strisho nga Komuna jonë dhe pastaj t'i dërgojmë në Komunën e Prizrenit. Gjithashtu edhe për materialet shpenzuese, siç janë prezervativët, si dhe kisha pas një çështje tjetër, që është transporti i punonjësve shëndetësorë. Ju falemnderit!

**Adelina Dauti, infermiere:** Përshëndetje për të gjithë! Propozimi im ka të bëjë me transportin publik, i sigurt dhe i përshtatshëm për gratë të cilat janë të punësuar në vendet rurale, nga qyteza e Dragashit si dhe anasjelltas, duke mundësuar tre linja, në mëngjes, drekë dhe darkë. Njëherit, shfrytëzoj rastin ta falënderoj kryetarin dhe të gjithë stafin për mbështetjen e deritanishme që keni dhënë për furnizimin me ilaçe për raste emergjente në Urgjencën e Dragashit. Ju falemnderit shumë! Besoj që edhe për propozimin tim do të merrni një vendim pozitiv!

**Elisa Rashiti, OJQ "Avoko":** Përshëndetje për të gjithë! Njëra prej kërkesave të grave është kërkesa për hapjen e çerdheve dhe kopshteve publike, ose edhe subvencionim të kujdesit privat për fëmijët. Në këtë mënyrë lehtësohet pjesëmarrja e grave në tregun e punës. Ato ofrojnë një mjedis të sigurt dhe të kujdesshëm, ku fëmijët mund të zhvillohen, mësojnë dhe socializohen. Ne si gra do të kemi më shumë mundësi për të punuar. Ne si gra, kërkojmë financim për ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve, kërkojmë standarde të cilësisë, si dhe qasje për të gjithë. Ju faleminderit!

**Ajna Qengaj, OJQ "Avoko":** Përshëndetje për të gjithë! Si kërkesë tjetër për gratë, e kemi paraqitur si ambient mbrojtës për gratë të cilat janë të divorcuara, të cilat i nënshtrohen dhunës fizike, psikologjike, për një strehim të tyre. Mendoj se krijimi i strehimoreve dhe shërbimeve mbështetëse për gratë që janë të divorcuara apo edhe të dhunuara, do t'u ndihmonte atyre shumë për krijimin e një ambienti të sigurt dhe përkrahës. Për shembull, duke iu siguruar atyre zhvillim personal, trajtim në aspektin emocional dhe psikologjik, si dhe lehtësim për rimëkëmbjen e tyre. Kështu që, mendoj se do të ishte shumë e nevojshme. Mendoj se një hapësirë e veçantë që do të zinte vend për strehimin e tyre do të ishin banesat të cilat janë pas DKRS-së, kati përdhes do të ishte një vend shumë i posaçëm. Ju faleminderit!

**Alma Krasniqi, OJQ "Avoko":** Përshëndetje për të gjithë! Propozimi im, bashkë me disa anëtare që janë të pranishme këtu, është që të krijojmë një panair, nga të dyja komunitetet. Shumica e grave të vendit tonë, të paktën nga një nëpër shtëpi, e dimë që janë të afta që të bëjnë veshje ose punime dore të ndryshme, të cilat mund të arrijmë me i shit, sidomos në sezonin veror, kur e dimë që mërgata janë të pranishëm, dhe janë të gatshëm për të marrë ndonjë zyref ose ndonjë këmishë të punuar nga gratë dhe nënat tona. Përpos veshjeve tradicionale dhe punimeve të dorës, me arrit edhe me ushqime me e realizue, pasi që ushqimet tradicionale të trevës sonë janë shumë të njohura. Ato ushqime gjithashtu mundën edhe me u ble, po edhe me u konsumue aty. Ky panair me u mbajt një herë në muaj, ku të gjitha gratë dhe vajzat mundën me qenë prezente.

**Lindita Kozmaqi Piraj:** Atëherë, ne i kemi shkruar dhe i kemi mbajt evidencat. Shpresojmë se do të hasim në mirëkuptimin e kryetarit dhe stafit. Me thënë të drejtën, kërkesat ishin shumë me vend dhe shumë të arsyeshme, dhe vijnë nga të gjitha grupmoshat. Disa prej tyre janë që sa vite me radhë, sidomos kërkesat për transportin. Pra, edhe vitin e kaluar një prej kërkesave ka qenë transporti me fshatrat dhe me Dragashin, sepse Opoja dihet që me Prizrenin ka lidhje të mira transporti, ndërsa me Dragashin nuk ka transport të rregullt. Transporti i atyre grave, jo vetëm të punësuarave, do të ndihmojë të integrohen në shoqëri, dojnë të jenë pjesëmarrëse në takime, të bëjnë një vizitë, një shërbim çfarëdoqoftë, ato nuk kanë një transport në çfarëdo kohe. Të paktën të shtohen linjat, të mendojmë edhe për këtë. Kemi diskutuar edhe me kryesuesen edhe më herët këtë çështjen e



transportit. Kështu që është një kërkesë me vend, përveç kërkesa e të gjitha grave, e kahmotshme, peticioni, që edhe Dragash-Prizren dhe anasjelltas, kemi mangësi linjat buxhetore dhe kemi problematikë vijueshmërinë në punë të gjitha neve të cilat punojmë. E di që një kërkesë kryetari e ka bo menjëherë, sapo e kemi nënshkruar peticionin. Shfrytëzoj rastin të njoftoj se tash ka fillu edhe një hulumtim pikërisht rreth transportit. Një projekt me dy komuna në Kosovë, Prishtinën dhe ka përzgjedhë Dragashin. Kështu që, jemi të privilegjuar që me anë të këtij hulumtimi të del në pah. Do të bëhet njëfarë analize e gjithë këtyre linjave, kush shërbehet me to dhe ku jemi ne si gjini. Kërkesart ishin të arsyeshme, po megjithatë, nëse jo të gjitha mund të hyjnë në buxhetin e vitit të ardhshëm, të paktën kërkesat e njëjta të mundohemi t'i shtyjme. Faleminderit!

**Anila Trupaj:** Përshëndetje për të gjithë! Propozimi im është që ta hapim një fabrikë për punësimin e grave, që ka qenë hapur edhe para disa viteve. Por nëse bëhet edhe hapja e çerdheve, do të bëhet edhe shumë më lehtë për gratë që me punue, sepse i kanë fëmijët më të sigurt edhe punojnë më qetë. Faleminderit!

**Erona Zyberi:** Përshëndetje për të gjithë! Ne tashmë kemi gjinekologe në Komunën tonë. Kërkojmë nga kryetari i Komunës që të mundësojë sigurimin e mjeteve të nevojshme për funksionalizimin e sallës së lindjes në QKMF të Dragashit.

**Arijeta Skeraj:** Atëherë, deri tash ishin dhjetë kërkesa. Këto do t'i dërgohen kryetarit të Komunës që t'i shqyrtojnë mundësitë për futjen në buxhetim të tyre. Unë dua të ju përshëndes secilën veç e veç, në veçanti e përshëndes OJQ-në "Avoko" që e ka bërë të mundur këtë pjesëmarrje të këtyre grave. Ju faleminderit!

**Resul Fetahu:** Faleminderit, kryesuese! Atëherë, ne kërkesat i kemi marrë, shpresojmë që do t'u përgjigjemi pozitivisht të gjithave! Ju faleminderit për pjesëmarrjen!

**Linqet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:**

**Në uebfaqe:**

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-me-gra-dhe-vajza-per-buxhetin-e-virit-2025/>

**Në Facebook:**

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/k3yk3UyeqSnsDZn3/>

Boshnjakisht: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0PIRBvxR4yr8NmqlKe7n8GZw8ZEFWKpZXI8YZchSMY2KoQkUTwo9FjcmQQENscBeFl&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0PIRBvxR4yr8NmqlKe7n8GZw8ZEFWKpZXI8YZchSMY2KoQkUTwo9FjcmQQENscBeFl&id=100066575766996)

**SHTOJCË:** *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO**  
**KOMUNA E DRAGASHIT**  
**DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Data/Datum: 31.07.2024

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

**LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR**  
**ME GRA DHE VAJZA PËR BUXHETIN E VITIT 2025**

**LISTA UÇESNIKA NA RASPRAVA BUDŽETA**  
**SA ŽENAMA I DEVOJKAMA ZA BUDŽET ZA 2025 GODINU**

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Etnia	M	F	Nënshkrimi
Br.	Ime i Prezime	Prebivalište	Etnička pripadnost	M	Ž	Potpis
1	Vhohuqe Elshani	Brezne	<del>DEKOR</del> Shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
2	ELA QAFLESHI	BELLOBRAD	SHQIPTARE		✓	<i>[Signature]</i>
3	Alma Salibi	Bresanë	SHQIPTARE		✓	<i>[Signature]</i>
4	Katlyna Krasniqi	Brezne	Shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
5	Mirela Skeraj	Brenc	shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
6	Medina Asipi	Dragash	shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
7	Blertha Asipi	DRAGASH	shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
8	Valbona Zejneli	Dragash	Shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
9	NIMEZE BERISHA	DRAGASH	SHQIPTARE		✓	<i>[Signature]</i>
10	MIMOZE BERISHA	DRAGASH	SHQIPTARE		✓	<i>[Signature]</i>
11	ANESA MGHMETI	ZGATAR	SHQIPTARE		✓	<i>[Signature]</i>
12	Skada Bajrami	Dragash	shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
13	IBRAHIM KRASHANI	XERREKANI	shqiptare	✓	✓	<i>[Signature]</i>
14	Lijana Dauti	Dragash	shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
15	Rejza Dauti	Dragash	shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
16	Hona Saiti	Dragash	shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
17	Ajina Ramaj	Dragash	shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
18	ESHIRE SKERAJ	Brenc	shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
19	Friola Gerdellaj	Brenc	shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
20	ELSA KRASHANI	DRAGASH	SHQIPTARE		✓	<i>[Signature]</i>
21	ERONA KRASHANI	DRAGASH	SHQIPTARE		✓	<i>[Signature]</i>
22	Alme Krasniqi	DRAGASH	shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
23	Erona Zyberi	Dragash	shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
24	Anila Trupaj	Dragash	shqiptare		✓	<i>[Signature]</i>
25	Neva Bedini	Prizeren	Borane		✓	<i>[Signature]</i>
26	Vaneta Gerdellaj	Dragash	SHQIPTARËS		✓	<i>[Signature]</i>
27	Erona Rusini	DRAGASH	SHQIPTARËS		✓	<i>[Signature]</i>

Komuna e Dragashit  
Opština Dragaš

02 Nr. Br400/01-16376/24  
31.07.2024  
Dragash - Dragaš



28	Jolida Misini	Dragash	shqiptare		✓	<del>Konice</del>
29	<del>Nezha Mamija</del>	<del>Brzene</del>	<del>Shqiptare</del>		✓	<del>Konice</del>
30	<del>EIZA BECIRI</del>	<del>PRIZREN</del>	<del>GORAN</del>		✓	<del>ELGA. B</del>
31	Bajreta Selimi	Dragash	Shqiptare		✓	Belimi
32	ADELINA DAUTI	Dragash	Kosovare		✓	A. Dauti
33	AYRIJE MERI	DRAGASH	KOSOVARE		✓	<del>A. Dauti</del>
34	MIRJETA KASHITI	DRAGASH	KOSOVARE		✓	Kashiti
35	Elisa Rashiti	Dragash	Kosovare		✓	<del>Rashiti</del>
36	Semina Misini	Dragash	Kosovare		✓	Semina
37	LINDITA PIRAJ	Dragash	Shq		✓	Lim
38	ARJETA SKERAJ	DRAGASH	KOSOVARE		✓	Alkeraj
39	RESUL FETAHU	Dragash	Kosovar		✓	Fetahu
40						
41						
42						
43						
44						
45						
46						
47						
48						
49						
50						
51						
52						
53						
54						
55						
56						
57						
58						
59						
60						
61						
62						
63						
64						
65						
66						
67						
68						
69						
70						







